



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË
PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE
INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 3949 / Prot.
1

Tiranë, më 11.03 .2022

UDHËZIM

Nr. 33 , Datë 11.03 2022

“PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 927, DATË 1.11.2021 “PËR MËNYRËN DHE PROCEDURËN E PLOTËSIMIT TË DEKLARATAVE TË PASURISË DHE INTERESAVE PRIVATË NË FORMË ELEKTRONIKE NË SISTEMIN ELEKTRONIK PËR DEKLARIMIN E PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESIT (EACIDS)”

Në mbështetje të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 330, datë 22.4.2020 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore ‘Sistemi i deklarin të pasurisë dhe konfliktit të interesit – EACIDS’”, si dhe shkresave nr. 1021/1 prot, datë 9.3.2021 dhe nr. 1021/2 prot, datë 9.3.2021, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;

UDHËZON:

Pika 8, gërma “a” ndryshon si më poshtë vijon:

8. Subjektet deklaruese duhet të plotësojnë deklaratat e interesave privatë përkatëse, sipas mënyrës dhe afateve të mëposhtme:
 - a) Subjektet të cilët mbartin detyrimin ligjor të bëjnë deklarinin periodik vjetor të interesave privatë dhe konfliktit të interesave, për vitin 2021, duhet të plotësojnë Deklaratën e Interesave Privatë Periodike Vjetore, në formë elektronike për subjektet në funksion, për pasuritë e akumuluar ndë vite dhe detyrimet financiare, me gjendje **në 31.12.2021**, si dhe burimin e krijimit të tyre. Deklarata e Interesave Privatë Periodike Vjetore, në formë elektronike, për subjektet në funksion, duhet plotësuar dhe dorëzuar brenda datës **31 tetor 2022**, si vijon:
 - **në formë elektronike**, duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI, dhe;

- **në formë shkresore**, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse dhe dorëzohet e mbyllur në zarf, pranë Autoritetit Përgjegjës të institucionit publik.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

Evgjeni BASHARI

